Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
MINISTRIA E SHËNDETËSISË/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA/MINISTRY OF HEALTH

UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MSH) Nr 04 / 2025 - MASAT DHE KUSHTET PËR SIGURINË E PACIENTIT, PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E INFEKSIONEVE NË KUJDESIN SHËNDETËSOR DHE REZISTENCËN ANTIMIKROBIKE

ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MoH) No. 04 / 2025 - MEASURES AND CONDITIONS FOR PATIENT SAFETY, PREVENTION AND CONTROL OF INFECTIONS IN HEALTHCARE AND ANTIMICROBIAL RESISTANCE

ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MZ) Broj 04 / 2025 - MERE I USLOVI ZA BEZBEDNOST PACIJENATA, PREVENCIJU I KONTROLU INFEKCIJA U ZDRAVSTVENOJ ZAŠTITI I ANTIMIKROBNA REZISTENTNOST

Në mbështetje të nenit 23 të Ligjit nr. 08/L-200 për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Ngjitëse (GZ Nr. 18/2023, me datë 08.08.2023) nenit 11, paragrafin 1, nënparagrafin 1.5 të Ligjit Nr.08/l-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, (GZ Nr. 34/2022, me datë 18.11.2022), nxjerr:	Pursuant to Article 23 of Law No. 08/L-200 on the Prevention and Control of Infectious Diseases (OG No. 18/2023, dated 08.08.2023), and Article 11, paragraph 1, subparagraph 1.5 of Law No. 08/L-117 on the Government of the Republic of Kosovo (OG No. 34/2022, dated 18.11.2022), the following is issued:	U skladu sa članom 23. Zakona br. 08/L-200 o sprečavanju i kontroli zaraznih bolesti (SL br. 18/2023, od 08.08.2023. godine) članom 11. stav 1. podstav 1.5. Zakona br. 08/l-117 o Vladi Republike Kosovo, (SL br. 18/2023 od 08.08.2023. godine), se izdaje:
UDHËZIM ADMINISTRATIV (MSH) Nr.04 / 2025 **MASAT DHE KUSHTET PËR SIGURINË E PACIENTIT, PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E INFEKSIONEVE NË KUJDESIN SHËNDETËSOR DHE REZISTENCËN ANTIMIKROBIKE**	**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MoH)No. 04 / 2025** **ON MEASURES AND CONDITIONS FOR PATIENT SAFETY, PREVENTION AND CONTROL OF HEALTHCARE-ASSOCIATED INFECTIONS, AND ANTIMICROBIAL RESISTANCE**	**ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MZ) Br.04 / 2025** **MERE I USLOVI ZA BEZBEDNOST PACIJENATA, PREVENCIJU I KONTROLU INFEKCIJA U ZDRAVSTVENOJ ZAŠTITI I ANTIMIKROBNA REZISTENCIJA**
Neni 1 **Qëllimi** Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është përcaktimi i masave dhe kushteve për fuqizimin e Sigurisë së Pacientit, për uljen e infeksioneve që merren gjatë ofrimit të kujdesit shëndetësor dhe për ruajtjen e veprimit efikas të antimikrobikëve në trajtimin e infeksioneve.	**Article 1** **Purpose** The purpose of this Administrative Instruction is to establish measures and conditions for strengthening patient safety, reducing healthcare-associated infections, and ensuring the effective use of antimicrobials in the treatment of infections.	**Član 1** **Svrha** Svrha ovog administrativnog uputstva je da definiše mere i uslove za jačanje bezbednosti pacijenata, za smanjenje infekcija stečenih tokom pružanja zdravstvene zaštite i za održavanje efikasnog delovanja antimikrobnih sredstava u lečenju infekcija.
Neni 2 **Fushëveprimi** Ky Udhëzim administrativ zbatohet nga personi fizik dhe juridik, publik dhe privat, institucioni shëndetësor dhe subjektet tjera përgjegjëse për zbatimin e masave dhe kushteve për sigurinë e pacientit, parandalimin e kontrollin e infeksioneve	**Article 2** **Scope** This Administrative Instruction applies to individual and legal persons, including public and private health institutions and other entities responsible for implementing measures and conditions related to patient safety, infection	**Član 2** **Obim** Ovo Administrativno uputstvo primenjuju fizička i pravna lica, javne i privatne, zdravstvene ustanove i drugi subjekti odgovorni za sprovođenje mera i uslova za bezbednost pacijenata, sprečavanje i kontrolu infekcija i

dhe rezistencën antimikrobike. **Neni 3** **Përkufizimet** 1.Shprehjet e përdorura në këtë udhëzim kanë këtë kuptim: 1.1.**Antibiotik:** substancë e prodhuar nga një mikroorganizëm apo e derivuar prej saj, e cila në mënyrë selektive shkatërron ose pengon rritjen e mikroorganizmave të tjerë; 1.2.**Antimikrobik**: çdo substancë me origjinë natyrore, gjysmësintetike ose sintetike, e cila në përqëndrimet e saj *in vivo* i shkatërron mikroorganizmat ose pengon rritjen e tyre duke bashkëvepruar me një shënjestër të caktuar; 1.3.**Gabimi mjekësor** - çdo gabim ose lëshim i paqëllimshëm në ofrimin e kujdesit shëndetësor, që mund të shkaktojë dëmtim ose një rrezik potencial për pacientin. Ky mund të jetë gabim në diagnostikë, në trajtim, në dhënien e barnave, gabim procedural, dështim në komunikim, ose mungesë në zbatimin e masave të kontrollit të infeksioneve; 1.4.**Infeksion**: prani e një a më shumë mikroorganizmave në indet trupore apo lëngjet trupore, që shoqërohet me	prevention and control, and antimicrobial resistance. **Article 3** **Definitions** 1.The terms used in this document have the following meanings: 1.1.**Antibiotic**: a substance produced by or derived from a microorganism that selectively destroys or inhibits the growth of other microorganisms; 1.2.**Antimicrobial**: any substance of natural, semi-synthetic, or synthetic origin that, in its *in vivo* concentrations, destroys microorganisms or inhibits their growth by interacting with a specific target; 1.3.**Medical error**: any inadvertent act, omission, or deviation in the provision of healthcare that may cause harm or pose a potential risk to the patient. This may include errors in diagnosis, treatment, medication administration, procedural errors, communication failures, or lack of adherence to infection control measures; 1.4.**Infection**: the presence of one or more microorganisms in body tissues or fluids, accompanied by local or systemic clinical manifestations in the host.	otpornosti na antimikrobne lekove. **Član 3** **Definicije** 1. Izrazi koji se koriste u ovom uputstvu imaju sledeće značenje: 1.1.**Antibiotik:** supstanca proizvedena od ili dobijena od mikroorganizma koja selektivno uništava ili inhibira rast drugih mikroorganizama; 1.2.**Antimikrobno**: svaka supstanca prirodnog, polusintetičkog ili sintetičkog porekla, koja u svojim koncentracijama *in vivo* uništava mikroorganizme ili inhibira njihov rast interakcijom sa određenom metom; 1.3.**Lekarska greška** – svaka nenamerna greška ili propust u pružanju zdravstvene zaštite, koja može prouzrokovati štetu ili potencijalni rizik za pacijenta. Ovo može biti greška u dijagnozi, u lečenju, u davanju lekova, proceduralna greška, neuspeh u komunikaciji ili nedostatak sprovođenja mera kontrole infekcije; 1.4.**Infekcija** : prisustvo jednog ili više mikroorganizama u telesnim tkivima ili telesnim tečnostima, što je praćeno

manifestime klinike lokale apo sistemike tek strehuesi;		lokalnim ili sistemskim kliničkim manifestacijama kod domaćina;
1.5.**Infeksioni që merren gjatë kujdesit shëndetësor**: infeksioni që merret gjatë ofrimit të kujdesit shëndetësor në një institucion shëndetësor dhe që ndërlidhet me masat diagnostike, terapeutike ose të kujdesit shëndetësor. Sipas legjislacionit aktual në Kosovë, për definimin e këtyre infeksioneve përdoren përkufizimet e infeksioneve sipas ECDC (European Centre for Disease Control and Prevention) ;	1.5.**Healthcare-associated infection** (HAI) – An infection acquired during the provision of healthcare in a health institution, linked to diagnostic, therapeutic, or healthcare measures. The definitions of healthcare-associated infections established by the European Centre for Disease Prevention and Control (ECDC) shall be applied as per current legislation in Kosovo;	1.5.**Infekcija stečena u zdravstvenoj zaštiti** : infekcija stečena tokom pružanja zdravstvene zaštite u zdravstvenoj ustanovi i vezana za dijagnostičke, terapijske ili zdravstvene mere. Prema važećem zakonodavstvu na Kosovu, definicije infekcija prema ECDC-u (Evropski centar za kontrolu i prevenciju bolesti) koriste se za definisanje ovih infekcija;
1.6.**Kolonizim**: prani e mikrobeve që jetojnë si mikrobiotë (florë normale) në trupin e njeriut dhe të cilat nuk japin shenja dhe simptoma të sëmundjes. Personat e kolonizuar nuk konsiderohen të sëmurë, por megjithatë ata mund t'i infektojnë personat përreth.	1.6.**Colonization**: the presence of microorganisms as part of the normal microbiota (flora) in the human body, without causing signs or symptoms of disease. Although colonized individuals are not considered sick, they may transmit microorganisms to others;	1.6.**Kolonizacija** : prisustvo mikroba koji živе kao mikrobiota (normalna flora) u ljudskom telu i koji ne pokazuju znake i simptome bolesti. Kolonizovani ljudi se ne smatraju bolesnima, ali i dalje mogu zaraziti ljude oko sebe;
1.7.**Kujdestaria për Antimikrobikët)**: qasje organizative gjithpërfshirëse shëndetësore, e cila promovon dhe monitoron përdorimin optimal të antimikrobikëve, duke ruajtuar cilësinë dhe sigurinë e tyre;	1.7.**Antimicrobial Stewardship**: a comprehensive healthcare system approach that promotes and monitors the optimal use of antimicrobials, ensuring their quality, safety, and effectiveness;	1.7.**Antimikrobno upravljanje**: sveobuhvatan zdravstveni organizacioni pristup koji promoviše i prati optimalnu upotrebu antimikrobnih sredstava, održavajući njihov kvalitet i bezbednost;
1.8.**Mikroorganizmi multirezistent:** mikroorganizmi që nuk është i ndjeshëm ndaj së paku një antibiotiku në secilën prej tri apo më shumë klasëve të antibiotikëve (ose dy e më shumë te *Mycobacterium tuberculosis*) ;	1.8.**Multiresistant microorganism**: microorganism that is not susceptible to at least one antibiotic in three or more antibiotic classes (or two or more in	1.8.**Multirezistentni mikroorganizam:** mikroorganizam koji nije osetljiv na najmanje jedan antibiotik u svakoj od tri ili više klasa antibiotika (ili dve ili više u *Mycobacterium tuberkulosis*);

1.9.**Ngjarje e padëshiruar**: një incident që rezulton në dëmtimin e pacientit.	*Mycobacterium tuberculosis*); 1.9.**Adverse event**: an incident that results in harm to the patient;	1.9.**Neželjeni događaj** : incident koji dovodi do povrede pacijenta.
1.10.**"Një Shëndet" ("One Health")** - qasje unifikuese që determinon se shëndeti i njerëzve është i lidhur ngushtë me shëndetin e kafshëve dhe mjedisin tonë të përbashkët;	1.10.**"One Health"**: a unified approach recognizing that human health is closely interconnected with the health of animals and the environment;	1.10.**„Jedno zdravlje" ("One Health")** – je objedinjujući pristup koji utvrđuje da je zdravlje ljudi usko povezano sa zdravljem životinja i našeg zajedničkog okruženja.
1.11.**Përdorimi optimal i antimikrobikëve**: përdorimi i antimikrobikëve, nga i cili përfiton pacienti dhe njëkohësisht ulet mundësia e efekteve anësore dhe e shfaqjes së rezistencës;	1.11.**Optimal use of antimicrobials**: the administration of antimicrobials in a manner that maximizes patient benefit while minimizing the risk of adverse effects and antimicrobial resistance;	1.11.**Optimalna upotreba antimikrobnih sredstava** : upotreba antimikrobnih sredstava, koja koristi pacijentu uz smanjenje mogućnosti neželjenih efekata i pojave rezistencije;
1.12.**Profilaksia antimikrobike:** përdorimi i antimikrobikëve për ta parandaluar infeksionin;	1.12.**Antimicrobial prophylaxis**: the use of antimicrobials to prevent infection;	1.12.**Antimikrobna profilaksa:** upotreba antimikrobnih sredstava za sprečavanje infekcije;
1.13.**Programet e kujdestarisë për antimikrobikët**: programe të koordinuara që zbatojnë intervenime për të siguruar përshkrimin optimal të antimikrobikëve;	1.13.**Antimicrobial Stewardship Programs**: coordinated programs that implement interventions to ensure appropriate antimicrobial prescribing and usage;	1.13.**Antimikrobni programi upravljanja** : koordinirani programi koji sprovode intervencije kako bi se osiguralo optimalno propisivanje antimikrobnih sredstava;
1.14.**Rast i dëmtimit të afërt ("near miss"):** një incident që prek pacientin gjatë ofrimit të kujdesit shëndetësor, por që nuk shkakton dëm tek pacienti;	1.14.**"Near Miss"**: an incident that occurs during healthcare delivery, which, although reaching the patient, does not result in harm;	1.14.**„Near miss":** incident koji utiče na pacijenta tokom pružanja zdravstvene zaštite, ali ne nanosi štetu pacijentu;
1.15.**Reagim i padëshiruar**: dëm i papritur si rezultat i një veprimi të arsyeshëm, ku është ndjekur procesi i duhur në kontekstin në të	1.15.**Adverse Reaction** – Unexpected harm resulting from an appropriate and reasonable medical action, despite	1.15.**Neželjena reakcija** : neočekivana šteta kao rezultat razumne radnje, pri čemu je poštovan odgovarajući proces u kontekstu u kojem se događaj desio;

cilin ndodhi ngjarja; 1.16.**Rezistenca ndaj antibiotikëve**: rezistenca e mikrooganizmit ndaj një antibiotiku të caktuar, i cili më parë ka qenë efikas në mjekimin e infeksioneve të shkaktuara nga ky mikroorganizëm. **Kapitulli I** **SIGURIA E PACIENTIT** **Neni 4** **Detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Shëndetësisë** 1.Ministria e Shëndetësisë përmes Divizionit të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit, si organ kompetent për Sigurinë e Pacientit në Kosovë ka këto detyra dhë përgjegjësi: 1.1.Harton, zbaton dhe përditëson politikat, standardet dhe praktikat më të mira për sigurinë e pacientit në përputhje me kriteret ndërkombëtare; 1.2.koordinon bashkëpunimin me Odat e profesionistëve shëndetësorë, shoqatat e pacientëve dhe shoqatat profesionale, në zhvillimin e politikave për sigurinë e pacientit; 1.3.siguron sistemin elektronik për	adherence to due procedures. 1.16.**Antibiotic resistance** : the ability of a microorganism to resist the effects of an antibiotic that was previously effective against infections caused by that microorganism. **Chapter I** **PATIENT SAFETY** **Article 4** **Duties and responsibilities of the Ministry of Health** 1. The Ministry of Health, through the Quality, Safety, and Accreditation Division, as the competent authority for Patient Safety in Kosovo, has the following duties and responsibilities: 1.1. Drafts, implements, and updates policies, standards, and best practices for Patient Safety in alignment with international criteria; 1.2. Coordinates cooperation with health professional chambers, patient associations, and professional organizations in the development of Patient Safety policies. 1.3. Provides and manages an electronic system	1.16.**Rezistencija na antibiotike** : otpornost mikroorganizma na određeni antibiotik, koji je ranije bio efikasan u lečenju infekcija izazvanih ovim mikroorganizmom. **Poglavlje I** **BEZBEDNOST PACIJENATA** **Član 4** **Dužnosti i odgovornosti Ministarstva zdravlja** 1. Ministarstvo zdravlja, preko Odeljenja za Kvalitet, Bezbednost i Akreditaciju, kao nadležno telo za bezbednost pacijenata na Kosovu, ima sledeće dužnosti i odgovornosti: 1.1.Razvija, sprovodi i ažurira politike, standarde i najbolje prakse za bezbednost pacijenata u skladu sa međunarodnim kriterijumima; 1.2.koordinira saradnju sa komorama zdravstvenih radnika, udruženjima pacijenata i strukovnim udruženjima, u izradi politike bezbednosti pacijenata; 1.3.obezbeđuje elektronski sistem za

grumbullimin e të dhënave të ndërlidhura me sigurinë e pacientit për gabimet mjekësore dhe ngjarjet anësore;	for collecting data related to Patient Safety, including medical errors and adverse events;	prikupljanje podataka koji se odnose na bezbednost pacijenata za lekarske greške i neželjene događaje;
1.4.mbikëqyr zbatimin e politikave për sigurinë së pacientit në të gjitha institucionet shëndetësore;	1.4. Oversees and ensures the implementation of Patient Safety policies across all health institutions;	1.4.nadgleda sprovođenje politike bezbednosti pacijenata u svim zdravstvenim ustanovama;
1.5.informon institucionet shëndetësore për masat dhe rekomandimet në fushën e sigurisë së pacientit;	1.5. Advises health institutions on necessary measures and recommendations for improving Patient Safety;	1.5.obaveštava zdravstvene ustanove o merama i preporukama u oblasti bezbednosti pacijenata;
1.6.bashkëpunon me Fakultetin e Mjekësisë në përfshirjen e sigurisë së pacientit në kurrikulën e edukimit akademik;	1.6. Collaborates with the Faculty of Medicine to integrate Patient Safety into academic curricula;	1.6.sarađuje sa Medicinskim fakultetom na uključivanju bezbednosti pacijenata u nastavni plan i program akademskog obrazovanja;
1.7.shkëmben njohuritë, përvojat dhe praktikat më të mira për Sigurinë e Pacientit në nivel vendor e ndërkombëtar.	1.7. Facilitates knowledge exchange by sharing experiences, research, and best practices on Patient Safety at both local and international levels.	1.7.razmenjuju znanja, iskustva i najbolje prakse za bezbednost pacijenata na lokalnom i međunarodnom nivou.
Neni 5 **Detyrat dhe përgjegjësitë e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK)**	**Article 5** **Duties and responsibilities of the National Institute of Public Health of Kosovo (NIPHK)**	**Član 5** **Dužnosti i odgovornosti Nacionalnog instituta za javno zdravlje Kosova (NIJZK)**
1.Mirëmban modulin elektronik për grumbullimin, analizën dhe raportimin e të dhënave për sigurinë e pacientit;	1.Maintains and manages the electronic module for the collection, analysis, and reporting of Patient Safety data;	1.Održava elektronski modul za prikupljanje, analizu i izveštavanje podataka o bezbednosti pacijenata;
2.Informon dhe koordinon trajnime për pacientët dhe publikun për sigurinë e pacientit, të drejtat dhe obligimet e pacientit, praktikat e sigurta të kujdesit shëndetësor dhe masat parandaluese për të ulur	2.Informs and coordinates training programs for patients and the public on Patient Safety, patient rights and obligations, safe healthcare practices, and preventive measures to reduce medical errors	2.informiše i koordinira obuku pacijenata i javnosti o bezbednosti pacijenata, pravima i obavezama pacijenata, bezbednoj zdravstvenoj praksi i preventivnim merama za smanjenje

gabimet mjekësore dhe ngjarjet anësore, në bashkëpunim me grupet e avokimit; 3.Përgatit raportin vjetor për praktikat e sigurisë së pacientit dhe jep rekomandime për avansimin e tyre në sistemin shëndetësor; 4.Avokon për përmirësime të vazhdueshme në praktikat e sigurisë së pacientit dhe mbështet integrimin e tyre në kujdesin shëndetësor; 5.Mbështet kërkimin shkencor në fushën e sigurisë së pacientit, duke ndjekur praktikat e bazuara në dëshmi. **Neni 6** **Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Mjekësore (AKPPM)** 1.Mundëson që barnat dhe pajisjet mjekësore të jenë të sigurta dhe efektive para se të lejohen në treg; 2.Vlerëson sigurinë e barnave dhe pajisjeve mjekësore përmes mbikëqyrjes pas autorizimit dhe sistemit të farmakovigjilencës; 3.Vendos, zbaton dhe monitoron standardet e cilësisë për prodhimin, etiketimin dhe shpërndarjen e barnave dhe pajisjeve mjekësore;	and adverse events, in collaboration with advocacy groups; 3.Prepares an annual report on Patient Safety practices and provides recommendations for their improvement within the health system; 4.Advocates for continuous improvement in Patient Safety measures and actively supports their integration into healthcare services; 5. Supports scientific research in the field of Patient Safety, ensuring adherence to evidence-based practices. **Article 6** **Duties and responsibilities of the Kosovo Agency for Medical Products and Devices (KAMPD)** 1.Ensures that drugs and medical devices meet safety and efficacy standards before being approved for market entry; 2.Conducts post-authorization surveillance and the pharmacovigilance system to monitor drug and medical device safety. 3.Establishes, implements, and monitors quality standards for the production, labeling, and distribution of drugs and medical devices.	lekarskih grešaka i neželjenih događaja, u saradnji sa grupama za zastupanje; 3.priprema godišnji izveštaj o praksi bezbednosti pacijenata i daje preporuke za njihovo unapređenje u zdravstvenom sistemu; 4.zalaže se za kontinuirano unapređenje prakse bezbednosti pacijenata i podržava njihovu integraciju u zdravstvenu zaštitu; 5.m podržava naučna istraživanja u oblasti bezbednosti pacijenata, prateći praksu zasnovanu na dokazima. **Član 6** **Dužnosti i odgovornosti Kosovske agencije za medicinske proizvode i uređaje (AKPPM)** 1.Omogućava da lekovi i medicinski uređaji budu bezbedni i efikasni pre nego što budu dozvoljeni na tržištu; 2.ocenjuje bezbednost lekova i medicinskih sredstava kroz postautorizacioni nadzor i sistem farmakovigilance; 3.utvrđuje, sprovodi i prati standarde kvaliteta za proizvodnju, obeležavanje i distribuciju lekova i medicinskih sredstava;

4.Paralajmëron dhe përditëson informata për tërheqjet eventuale të barnave dhe pajisjeve mjekësore nga tregu, që ndërlidhen me efektet anësore dhe problemet e tjera të sigurisë;	4.Issues warnings and updates on potential drug and medical device withdrawals due to safety concerns, including adverse effects and other risks.	4.upozorava i ažurira informacije o mogućem povlačenju lekova i medicinskih sredstava sa tržišta, u vezi sa neželjenim efektima i drugim bezbednosnim problemima;
5.Ofron udhëzime dhe informacione për punëtorët shëndetësor dhe publikun mbi përdorimin e sigurtë të barnave dhe pajisjeve mjekësore;	5.Provides guidance and information to healthcare professionals and the public on the safe use of drugs and medical devices.	5.pruža uputstva i informacije zdravstvenim radnicima i javnosti o bezbednoj upotrebi lekova i medicinskih sredstava;
6.Ndërmerr veprime ligjore kundër prodhuesve dhe shpërndarësve që shkelin rregulloret e sigurisë së barnave dhe pajisjeve mjekësore;	6.Takes legal action against manufacturers and distributors found in violation of drug and medical device safety regulations.	6.preduzeti pravne mere protiv proizvođača i distributera koji krše propise o bezbednosti lekova i medicinskih uređaja;
7.Siguron praktikat më të mira në përshkrimin, shpërndarjen dhe përdorimin e barnave dhe pajisjeve mjekësore për të minimizuar gabimet dhe efektet anësore.	7.Promotes best practices in the prescribing, dispensing, and use of drugs and medical devices to minimize errors and adverse effects.	7.obezbeđuje najbolje prakse u propisivanju, izdavanju i upotrebi lekova i medicinskih uređaja kako bi se greške i neželjeni efekti sveli na minimum.
Neni 7 **Detyrat dhe përgjegjësitë e institucionit shëndetësor dhe subjekteve të tjera që ofrojnë kujdes shëndetësor**	**Article 7** **Duties and responsibilities of the health institution and other entities that provide healthcare**	**Član 7** **Dužnosti i odgovornosti zdravstvene ustanove i drugih subjekata koji pružaju zdravstvenu zaštitu**
1.Zbaton politikat, standardet dhe praktikat më të mira të Sigurisë së Pacientit të përcaktuara nga MSh;	1.Implements Patient Safety policies, standards, and best practices as defined by the Ministry of Health;	1.Sprovodi politike, standarde i najbolju praksu bezbednosti pacijenata kako ih definiše Ministarstvo zdravlja;
2.Siguron që të gjitha praktikat e kujdesit shëndetësor të jenë në përputhje me protokollet e sigurisë, veçanërisht në fushat e sigurisë së barnave, kontrollit të infeksioneve dhe ndërhyrjeve kirurgjikale;	2.Ensures compliance with safety protocols across all healthcare practices, particularly in drug safety, infection control, and surgical interventions;	2.obezbeđuje da su sve prakse zdravstvene zaštite u skladu sa bezbednosnim protokolima, posebno u oblastima bezbednosti lekova, kontrole infekcija i hirurških intervencija;

3.Informon pacientët dhe kujdestarët për të drejtat e tyre, opcionet e trajtimit, rreziqet potenciale dhe rëndësinë e pëlqimit të informuar (pëlqimi me shkrim nga pacienti ose kujdestari);	3.Informs patients and caregivers about their rights, treatment options, potential risks, and the importance of obtaining informed consent (written consent from the patient or caregiver);	3.informiše pacijente i negovatelje o njihovim pravima, opcijama lečenja, potencijalnim rizicima i važnosti informisanog pristanka (pisani pristanak pacijenta ili negovatelja);
4.Mbledh, raporton dhe analizon të dhënat për kategorinë dhe shkaqet e gabimeve mjekësore, efekteve anësore dhe gabimeve që nuk e dëmtojnë pacientin ("near miss");	4.Collects, reports, and analyzes data on medical errors, adverse effects, and "near-miss" incidents;	4.prikuplja, izveštava i analizira podatke o kategoriji i uzrocima lekarskih grešaka, neželjenih efekata i grešaka koje ne štete pacijentu („near miss");
5.Siguron një mjedis institucional për raportimin e gabimeve mjekësore, që është i hapur, i drejtë dhe jondëshkues ndaj atyre që raportojnë;	5.Establishes a supportive reporting environment for medical errors that is open, fair, and non-punitive to those who report;	5.obezbeđuje institucionalno okruženje za prijavljivanje medicinskih grešaka koje je otvoreno, pravično i nekažnjivo za one koji prijavljuju;
6.Detyron punëtorët shëndetësorë që të raportojnë gabimet mjekësore në mënyrë aktive;	6.Mandates healthcare workers to actively report medical errors;	6.primorava zdravstvene radnike da aktivno prijavljuju lekarske greške;
7.Krijon një sistem të raportimit anonim për gabimet mjekësore ose shkeljet e protokolleve të sigurisë;	7.Develops an anonymous reporting system for medical errors or violations of safety protocols;	7.uspostavlja sistem anonimnog prijavljivanja medicinskih grešaka ili kršenja sigurnosnih protokola;
8.Raportimi në pikat 5 dhe 6 të nenit 7, nuk përfshin rastet dhe procedurat që lidhen me neglizhencë, keqtrajtim të pacientit gjatë ofrimit të kujdesit shëndetësor dhe shkeljet tjera të kodit etik e profesional mjekësor;	8.Reporting obligations in points 5 and 6 of Article 7 do not include cases related to negligence, patient mistreatment, or other violations of the ethical and professional medical code;	8.prijavljivanje u tačkama 5. i 6. člana 7. ne obuhvata slučajeve i postupke koji se odnose na nemar, maltretiranje pacijenta tokom pružanja zdravstvene zaštite i druga kršenja etičkog i profesionalnog medicinskog kodeksa;
9.Mundëson pacientëve dhe kujdestarëve të tyre që të raportojnë përvojat e tyre, vërejtjet dhe ankesat gjatë ofrimit të kujdesit shëndetësor në kutinë e ankesave përbrenda institucionit, ose në	9.Enables patients and caregivers to report their experiences, observations, and complaints through a designated complaint box within the institution or via the toll-free complaint line	9.omogućava pacijentima i njihovim starateljima da prijave svoja iskustva, zapažanja i pritužbe tokom pružanja zdravstvene zaštite u kutiji za žalbe u okviru ustanove, ili na

linjën falas të ankesave në numrin 08001777, përfshirë termat dhe kushtet kur ato mund të aplikohen;	(08001777), including specified terms and conditions for submissions;	besplatnoj liniji za žalbe na 08001777, uključujući i uslove pod kojima se mogu primeniti;
10.Siguron trajnime për sigurinë e pacientit për të gjithë profesionistët shëndetësor, të cilat akreditohen nga Odat e profesionistëve shëndetësorë;	10.Provides accredited patient safety training for all healthcare professionals, accredited by the Chambers of Health Professionals;	10.obezbeđuje obuku o bezbednosti pacijenata za sve zdravstvene radnike, što je akreditovano od Komore zdravstvenih radnika;
11.Vlerëson në bazë vjetore praktikat e sigurisë së pacientit përmes auditeve dhe informatave kthyese dhe ndërmerr hapa përkatës për përmirësimin e tyre;	11.Conducts annual evaluations of patient safety practices through audits and feedback mechanisms and implements necessary improvements;	11.procenjuje prakse bezbednosti pacijenata na godišnjem nivou kroz revizije i povratne informacije i preduzima odgovarajuće korake da ih poboljša;
12.Promovon përdorimin e teknologjive të avancuara informative për analizën e të dhënave dhe identifikimin e rreziqeve potenciale;	12.Promotes the use of advanced information technologies for data analysis and risk identification;	12.promoviše upotrebu naprednih informacionih tehnologija za analizu podataka i identifikaciju potencijalnih rizika;
13.Obligohen që të gjitha masat e sipërshënuara t'i shenjëzojnë dhe t'i bëjnë të dukshme brenda hapësirave të institucionit shëndetësor.	13.Ensures that all Patient Safety measures are clearly marked and visibly displayed within healthcare institutions.	13.dužni su da sve navedene mere obeleže i učine vidljivim u prostorijama zdravstvene ustanove.
Neni 8 **Detyrat dhe përgjegjësitë e punëtorit shëndetësor**	**Article 8** **Duties and responsibilities of the health worker**	**Član 8** **Dužnosti i odgovornosti zdravstvenog radnika**
1.Zbaton standardet e përcaktuara të sigurisë së pacientit, protokollet dhe praktikat më të mira profesionale në ofrimin e kujdesit shëndetësor;	1.Ensures compliance with established Patient Safety standards, protocols, and best professional practices in healthcare delivery;	1.Primenjuje utvrđene standarde bezbednosti pacijenata, protokole i najbolju profesionalnu praksu u pružanju zdravstvene zaštite;
2.Raporton tek koordinatori i cilësisë së institucionit përkatës ose në IKSHPK për gabimet	2.Reports medical errors and adverse events to the quality coordinator of the respective	2.izveštava koordinatora kvaliteta relevantne institucije ili IKSHPK o medicinskim greškama

mjekësore dhe ngjarjet e padëshiruara; 3.Merr pjesë në trajnimet ndërdisiplinore për sigurinë e pacientit; 4.Obligohet të verifikojë identitetin e pacientit dhe trajtimin e përcaktuar para fillimit të çdo trajtimi të pacientit; 5.Obligohet ta informojë pacientin për diagnozën e tij, opcionet e trajtimit dhe rreziqet e mundshme; 6.Respekton të drejtat e pacientëve për kujdes të sigurt shëndetësor, privatësi dhe pëlqim të informuar; 7.Bashkëpunon me profesionistët tjerë të kujdesit shëndetësor dhe personelin administrativ për të promovuar kulturën e sigurisë së pacientit përbrenda institucionit shëndetësor. **Neni 9** **Detyrat dhe përgjegjësitë e pacientit** 1.Respekton rregullat shtëpiake dhe udhëzimet e vendosura nga institucioni shëndetësor; 2.Informon me vërtetësi që në takimin e parë me stafin shëndetësor për gjendjen e tij shëndetësore, alergjitë eventuale, barnat që përdor dhe çdo procedurë të mëparshme mjekësore;	institution or the NIPHK; 3.Participates in interdisciplinary training on Patient Safety; 4.Is obliged to verify patient identity and prescribed treatment before initiating any medical treatment; 5.Is obliged to inform patients about their diagnosis, treatment options, and potential risks; 6.Upholds patient rights to safe healthcare, privacy, and informed consent; 7.Collaborates with healthcare professionals and administrative staff to foster a culture of Patient Safety within the institution. **Article 9** **Duties and responsibilities of the patient** 1.Adheres to the household rules and guidelines established by the healthcare institution; 2.Provides truthful information during the initial consultation with healthcare staff regarding their health condition, allergies, medications, and previous medical procedures;	i neželjenim događajima; 3.učestvuje u interdisciplinarnoj obuci o bezbednosti pacijenata; 4.dužan je da pre otpočinjanja bilo kakvog lečenja pacijenta proveri identitet pacijenta i propisano lečenje; 5.dužan je da obavesti pacijenta o njegovoj dijagnozi, mogućnostima lečenja i mogućim rizicima; 6.poštuje prava pacijenata na bezbednu zdravstvenu zaštitu, privatnost i informisani pristanak; 7.sarađuje sa drugim zdravstvenim radnicima i administrativnim osobljem na promovisanju kulture bezbednosti pacijenata u okviru zdravstvene ustanove. **Član 9** **Dužnosti i odgovornosti pacijenta** 1.Poštuje kućna pravila i smernice koje je ustanovila zdravstvena ustanova; 2.istinito obaveštava na prvom sastanku sa zdravstvenim osobljem o svom zdravstvenom stanju, mogućim alergijama, lekovima koje koristi i svim prethodnim medicinskim procedurama;

3.Raporton menjëherë te mjeku ose stafi shëndetësor rastet kur vëren diçka të pazakontë gjatë trajtimit të tij (efekt anësor nga barnat, ose një ndryshim të papritur në gjendjen e tij);	3.Immediately notifies the doctor or healthcare staff of any unusual changes during treatment, including drug side effects or sudden health deterioration;	3.odmah se javi lekaru ili zdravstvenom osoblju kada primeti nešto neobično tokom lečenja (nuspojava lekova, ili iznenadna promena njegovog stanja) ;
4.Respekton udhëzimet mjekësore, përfshirë marrjen e barnave në dozë dhe orar të caktuar;	4.Follows medical instructions, including taking medications in the correct dosage and schedule;	4.poštuje medicinska uputstva, uključujući uzimanje lekova u propisanoj dozi i rasporedu;
5.Zbaton masat parandaluese të infeksionit (higjiena e duarve, higjiena personale, maskat, izolimi, vizitat e paautorizuara të familjarëve);	5.Implements infection prevention measures (hand and personal hygiene, mask use, isolation, and restricting unauthorized family visits);	5.sprovodi mere prevencije infekcija (higijena ruku, lična higijena, maske, izolacija, neovlašćene posete članova porodice);
6.Raporton ankesat ose përvojat e padëshiruara gjatë ofrimit të kujdesit shëndetësor në kutinë e ankesave përbrenda institucionit, ose në linjën falas të ankesave;	6.Reports complaints or adverse experiences related to healthcare services via the institution's complaint box or the toll-free complaint line;	6.prijavljuje pritužbe ili štetna iskustva tokom pružanja zdravstvene zaštite u kutiju za žalbe u ustanovi, ili na besplatnu liniju za žalbe;
7.Mund të kërkojë një mendim të dytë profesional, nëse ka dyshime për diagnozën ose trajtimin e propozuar;	7.Has the right to seek a second professional opinion if uncertain about a diagnosis or proposed treatment;	7.može tražiti drugo stručno mišljenje, ako postoji sumnja u dijagnozu ili predloženi tretman;
8.Mund të përfshihet në aktivitetet e shoqatave të pacientëve për zhvillimin e politikave dhe programeve të sigurisë së pacientit.	8.May participate in patient association activities to contribute to the development of Patient Safety policies and programs.	8.može biti uključen u aktivnosti udruženja pacijenata za razvoj politike i programa bezbednosti pacijenata.
Neni 10 **Detyrat dhe përgjegjësitë e grupeve të avokimit**	**Article 10** **Duties and responsibilities of advocacy groups**	**Član 10** **Dužnosti i odgovornosti grupa za zastupanje**
1.Edukojnë publikun për sigurinë e pacientit dhe rëndësinë e praktikave të sigurta mjekësore;	1.Educates the public on Patient Safety and the importance of safe medical practices;	1.Obrazovati javnost o bezbednosti pacijenata i važnosti bezbedne medicinske prakse;
2.Avokojnë për legjislacionin dhe rregulloret që	2.Advocates for legislation and regulations that	2.zalagati se za zakone i propise koji

përmirësojnë standardet e sigurisë së pacientit; 3.Mundësojnë që të dëgjohet zëri i pacientëve dhe të mbrohen të drejtat e tyre brenda sistemit shëndetësor; 4.Ofrojnë informacione, mjete dhe mbështetje për pacientët dhe familjet e tyre për sigurinë e pacientit; 5.Bashkëpunojnë me institucionet qeveritare, organizatat shëndetësore dhe shoqatat profesionale për të promovuar praktikat më të mira dhe për të përmirësuar sigurinë e pacientit. **Kapitulli II** **INFEKSIONET QË MERREN GJATË KUJDESIT SHËNDETËSOR** **Neni 11** **Parimet e përgjithshme për organizimin e parandalimit dhe kontrollit të infeksioneve (PKI)** 1.Ministri i Shëndetësisë themelon Komitetin për Kontrollin e Infeksioneve gjatë kujdesit shëndetësor (KKIGJKSH), si organ kolegjial për koordinimin e politikave të PKI, konform Ligjit Nr. 08/L-200; 2. Organizimi i PKI në spitale bëhet përmes këshillit për parandalimin dhe kontrollin e	enhance Patient Safety standards; 3.Amplifies patients' voices and safeguards their rights within the healthcare system; 4.Provides information, tools, and support to patients and their families regarding Patient Safety; 5.Collaborates with government institutions, healthcare organizations, and professional associations to promote best practices and enhance Patient Safety. **Chapter II** **HEALTHCARE-ASSOCIATED INFECTIONS** **Article 11** **General principles for organizing infection prevention and control (IPC)** 1.The Minister of Health establishes the Infection Control Committee during Healthcare (ICCDHC) as a collegial body responsible for coordinating Infection Prevention and Control (IPC) policies, in accordance with Law No. 08/L-200. 2. The organization of IPC in hospitals is managed through the Hospital Infection Control	poboljšavaju standarde bezbednosti pacijenata; 3.omogućiti da se čuje glas pacijenata i zaštiti njihova prava u okviru zdravstvenog sistema; 4.pružaju informacije, alate i podršku pacijentima i njihovim porodicama o bezbednosti pacijenata; 5.sarađuju sa državnim institucijama, zdravstvenim organizacijama i profesionalnim udruženjima na promovisanju najboljih praksi i poboljšanju bezbednosti pacijenata. **Poglavlje II** **INFEKCIJE STEČENE TOKOM ZDRAVSTVENE ZAŠTITE** **Član 11** **Opšti principi za organizovanje prevencije i kontrole infekcija (IPC)** 1.Ministarstvo zdravlja osniva Komisiju za kontrolu infekcija tokom zdravstvene zaštite (KKITZZ) kao kolegijalni organ za koordinaciju politike PKI, u skladu sa Zakonom br. 08/L-200; 2.Organizacija PKI u bolnicama sprovodi se putem Saveta za bolničke infekcije i

infeksioneve dhe / ose njësisë / departamentit / divizionit për kontrollin e infeksioneve dhe rezistencën antimikrobike.	Council and the designated unit, department, or division for infection control and antimicrobial resistance.	odgovarajuće jedinice, odeljenja ili divizije za kontrolu infekcija i antimikrobne rezistencije.
3.Për parandalimin e infeksioneve në QKMF, institucionet private shëndetësore dhe institucionet sociale që ofrojnë edhe kujdes shëndetësor, përgjegjës për PKI është një person i caktuar me vendim nga menaxhmenti i institucionit.	3.For the prevention of infections in MFMCs, private healthcare institutions, and social institutions providing healthcare services, an IPC officer shall be designated by the institution's management through a formal decision.	3.za prevenciju infekcija u KKMF, privatnim zdravstvenim ustanovama i socijalnim ustanovama koje obavljaju i zdravstvenu zaštitu, odgovorno lice za PKI je lice određeno odlukom rukovodstva ustanove.
Neni 12 **Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Kontrollin e Infeksioneve gjatë kujdesit shëndetësor të MSH**	**Article 12** **Duties and Responsibilities of the Infection Control Committee at the Ministry of Health**	**Član 12** **Dužnosti i odgovornosti Odbora za kontrolu zdravstvenih infekcija MZ**
1.Zhvillon, rishikon, përditëson dhe monitoron udhëzimet, politikat, PSO dhe protokolet për PKI;	1.Develops, reviews, updates, and monitors guidelines, policies, Standard Operating Procedures (SOPs), and protocols for IPC;	1.Razvija, pregleda, ažurira i prati smernice, politike, PSO i protokole za PKI;
2.Siguron që këto udhëzime të jenë në përputhje me praktikat dhe standardet më të mira ndërkombëtare;	2.Ensures alignment of these guidelines with international best practices and standards;	2.osigurava da su ove smernice u skladu sa najboljim međunarodnim praksama i standardima;
3.Koordinon aktivitetet e PKI-së në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor;	3.Coordinates IPC activities at all levels of healthcare;	3.koordinira aktivnosti PKI na svim nivoima zdravstvene zaštite;
4.Mbikqyrë dhe koordinon bashkëpunimin me këshillat për kontrollin e infeksioneve në spitale;	4.Oversees and facilitates cooperation with hospital-based Infection Control Councils;	4.nadgleda i koordinira saradnju sa bolničkim savetima za kontrolu infekcija;
5.Dizajnon mbikqyerjen e infeksioneve dhe analizon të dhënat e mbledhura;	5.Designs and implements surveillance systems for HAIs, and analyzes collected data;	5.osmišljava nadzor infekcije i analizira prikupljene podatke;
6.Harton, zbaton dhe vlerëson programet për	6.Develops, implements, and evaluates	6.osmišljava, realizuje i ocenjuje programe

edukimin dhe trajnimin e vazhdueshëm profesional të stafit shëndetësor dhe atij ndihmës për PKI;	continuous professional education and training programs for healthcare and auxiliary staff on IPC;	kontinuiranog stručnog obrazovanja i usavršavanja zdravstvenog i pomoćnog osoblja za PKI;
7.Merr pjesë në projekte shkencore vendore e ndërkombëtare;	7.Participates in local and international scientific projects related to IPC;	7.učestvuje u domaćim i međunarodnim naučnim projektima;
8.Ofron ndihmesë teknike dhe këshilla profesionale për personat fizikë dhe juridikë në zbatimin e masave të PKI;	8.Provides technical assistance and expert guidance to individuals and institutions for the implementation of IPC measures;	8.pruža tehničku pomoć i stručne savete fizičkim i pravnim licima u sprovođenju PKI mera;
9.Bashkëpunon dhe shkëmben përvojat me institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare të PKI;	9.Collaborates and exchanges experiences with local and international IPC institutions;	9.sarađuje i razmenjuje iskustva sa domaćim i međunarodnim PKI institucijama;
10.Zhvillon dhe zbaton strategji për ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut mbi rëndësinë e PKI;	10.Develops and implements public awareness strategies to educate the population on the importance of IPC;	10.razvija i sprovodi strategije podizanja svesti i edukacije javnosti o značaju PKI;
11.Monitoron dhe vlerëson efektivitetin e programit të PKI;	11.Monitors and evaluates the effectiveness of IPC programs;	11.prati i ocenjuje efikasnost PKI programa;
12.Përgatit raporte vjetore për ecurinë e zhvillimeve programore të PKI.	12.Prepares annual reports on IPC program developments and progress.	12.priprema godišnje izveštaje o napretku programskog razvoja PKI.
Neni 13 **Parimet e organizimit të PKI në institucionet shëndetësore**	**Article 13** **Principles of organization of IPC in health institutions**	**Član 13** **Principi organizacije PKI u zdravstvenim ustanovama**
1.Çdo spital në Kosovë përmban njësinë/departamentin/ divizionin për kontrollin e infeksioneve dhe rezistencën antimikrobike;	1.Every hospital in Kosovo has a unit/ department / division for infection control and antimicrobial resistance;	1.Svaka bolnica na Kosovu ima jedinicu / odeljenje / diviziju za kontrolu infekcija i antimikrobnu rezistenciju;

1.1.Njësia/departamenti/divizioni udhëhiqet nga drejtori përkatës, që është specialist(e) me orar të plotë të punës. Pjesa tjetër e divizionit përbëhet nga infermierët e kontrollit të infeksionit. Numri i tyre përcaktohet nga numri i shtretërve të spitalit. Standardi i pranuar është 1 infermier i kontrollit të infeksioneve për çdo 250 shtretër të spitalit.	1.1. The unit/department/division is led by the director, who is a full-time specialist. The rest of the division is made up of infection control nurses. Their number is determined by the number of hospital beds. The accepted standard is one infection control practicioner for every 250 hospital beds.	1.1. Jedinicu/odeljenje/diviziju vodi direktor, koji je specijalista sa punim radnim vremenom. Ostatak odeljenja čine medicinske sestre za kontrolu infekcija. Njihov broj je određen brojem bolničkih kreveta. Prihvaćeni standard je jedna medicinska sestra za kontrolu infekcije na svakih 250 bolničkih kreveta.
1.2.Në spitalet me numër më të vogël të shtretërve, udhëheqësi i divizionit mund të jetë specialist i angazhuar me gjysmë orari;	1.2.In hospitals with a smaller number of beds, the head of the division may be a part-time specialist;	1.2.U bolnicama sa manjim brojem postelja, načelnik odeljenja može biti specijalista na određeno vreme;
2.Çdo spital në Kosovë formon këshillin për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve (KPKI).	2.Every hospital in Kosovo forms the Council for Infection Prevention and Control (CIPC);	2.svaka bolnica na Kosovu formira savet za prevenciju i kontrolu infekcija (SPKI).
3.Kryesues i KPKI është drejtori i njësisë/departamentit/divizionit për kontrollin e infeksioneve dhe rezistencën antimikrobike.	3.The head of CIPC is the director of the unit/department/division for infection control and antimicrobial resistance;	3.rukovodilac KKI je direktor odeljenja/divizije za kontrolu infekcija i antimikrobnu rezistenciju.
4.Këshilli përbëhet nga 11 anëtarë, me përfshirjen e këtyre profileve profesionale: infermieria, kirurgjia, anesteziologjia me kujdesin intenziv, sëmundjet ngjitëse, pediatria, farmakologjia, epidemiologjia, mikrobiologjia, mjekësia interne dhe një përfaqësues nga shërbimet teknike.	4.The council consists of 11 members, including these profiles: nursing, surgery, anesthesiology with intensive care, infectology, pediatrics, pharmacology, epidemiology, microbiology, internal medicine and one from technical services.	4.Savet ima 11 članova, a obuhvataju ove stručne profile: medicinska sestra, hirurgija, anesteziologija sa intenzivnom negom, infektivna medicina, pedijatrija, farmakologija, epidemiologija, mikrobiologija, interna medicina i predstavnik tehničkih službi.
5.KPKI ia paraqet raportin vjetor të punës për miratim drejtorit të spitalit dhe KKIGJKSH.	5.KKI submits the annual work report to the director of the hospital and KKIGJKSH for approval.	5.KKI dostavlja godišnji izveštaj o radu direktoru bolnice i KKIGJKSH na odobrenje.

Neni 14 Mbikqyrja dhe raportimi	Article 14 Monitoring and reporting	Član 14 Praćenje i izveštavanje
1.Spitalet obligohen që të kryejnë studime të prevalencës së infeksioneve spitalore në intervale të rregullta çdo 3-4 vjet. Kurse, në njësitë me rrezik të lartë për prekjen nga infeksionet që fitohen gjatë kujdesit shëndetësor, siç janë njësitë e kujdesit intensiv, kryhen edhe studimet e incidencës së këtyre infeksioneve në kohëzgjatje prej së paku 1-3 muaj gjatë një viti;	1.Hospitals are required to conduct prevalence studies on healthcare-associated infections (HAIs) at regular intervals, every 3 to 4 years. In high-risk units, such as intensive care units (ICUs), incidence studies on HAIs must be conducted for a minimum duration of 1 to 3 months per year;	1.Bolnice su u obavezi da sprovode studije prevalencije bolničkih infekcija u redovnim intervalima svake 3-4 godine. Međutim, u jedinicama sa visokim rizikom da budu pogođene infekcijama stečenim tokom zdravstvene zaštite, kao što su jedinice intenzivne nege, takođe se sprovode studije incidencije ovih infekcija u trajanju od najmanje 1-3 meseca tokom godine;
